



Krahas metodës katër-shkallëshe, përdorimi i së cilës, në shkollat e mesme profesionale në Kosovë është në rritje e sipër, këtu do të prezantohet edhe një metodë tjetër e mësimit praktik - *Metoda e përpunimit*. Në vitet e fundit në shumë vende perëndimore të Evropës, përdorimi i kësaj metode ka shënuar rritje intenzive.

Metoda e përpunimit të ushtrimit praktik ndahet në shkallët që vijojnë:

1. Faza e përgatitjes
2. Faza e përpunimit
3. Faza e kontrollimit
4. Faza e ushtrimeve

Hospitimet dhe bisedat e zhvilluara me mësuesin në shumë punëtori, tregojnë se shumë mësues në nivelin e përparuar të shkollimit zbatojnë metodën e përpunimit të mësimit praktik ose bëjnë kombinimin e të dy metodave!

Në vijim kemi një shembull lidhur me këtë metodë:

Projekt I mësimi praktik nga zeja e zdruktharisë

Tema: Gërryerja e një dërrase të rimesuar

Ndërmjetësimi në bazë të planprogramit të vitit të dytë shkollor

Vendmësimi	Punëtorja e zdruktharisë
Mjetet e shkollimit	1 palë fletore pune, 1 dërrasë e rimesuar, mjet koroziv, gome, dorëza gome, enë për ngjyrë, leckë, furçë
Koha e duhur	15 Minuta
Metoda	Metoda përpunuese e mësimi praktik
Qëllimet e mësimi	Nxënësi duhet në mënyrë të pavarur të bëjë gërryerjen e një sipërfaqeje të rimesuar duke pasqyruar masat e sigurisë. Përparësi në qëllimin e mësimi kanë kompetenca profesionale dhe ajo metodike.
Fushat e qëllimit mësimor:	Qëllimet pjesore:
Qëllimet mësimore kognitive	Nxënësi <ul style="list-style-type: none"> - Mund të përshkruajë se si e zhvillon punën në mënyrë të pavarur - Mund të sqarojë drejtimit e drurit - Mund të sqarojë se cilat masa të sigurisë duhet respektuar - Mund të caktojë veglat e duhura të punës si dhe të përshkruajë përdorimin e tyre - Mund të vlerësojë vetë punën e tij
Qëllimet psikomotorike	<ul style="list-style-type: none"> - Mund të përdorë sipas nevojës veglat e punës - Mund të bëjë bartjen, shpërndarjen dhe tërheqjen e gërryerjeve në mënyrë të pavarur
Qëllimet mësimore afektive	<ul style="list-style-type: none"> - Është i gatshëm të punojë me kujdes - Është i gatshëm të respektojë masat e sigurisë

1. Faza përgatitore	
Përmbajtja e mësimit	Këshillat metodike
Paramendimi i temës	Këshillë, gërryerja është me rëndësi primare për profesion dhe sipas planprogramit shkollor duhet të ndërmjetësohet në vitin e dytë
Zgjimi i interesit	Të ceket, se si rezultat i dëshirës individuale të klientëve për llojin e mobileve, shpesh është i nevojshëm ndërrimi i tonit të drurit. Kjo mund të arrihet përmes gërryerjes. Nëse nevojitet, të rikujtohen në kërkesën e klientëve në kohën e fundit.
Sqarimi i qëllimit	Të përshkruhet shkurtimisht qëllimi i mësimit praktik dhe nxënësit ti sqarohet rëndësia e punës së pavarur dhe për këtë arsye priten nga ai zgjedhje të pavarura të ushtrimeve.
Përcaktimi i njohurive paraprake	Të pyetet nxënësi se a e ka parë se si zhvillohet apo ndoshta edhe kryer ndonjëherë një punë të tillë. Të pyetet se çka nënkupton ai me termin „Gërryerje“ dhe mundësisht ta sqarojë këtë term. Të bisedohet shkurtimisht lidhur me përgatitjen e dërrasës së drurit si dhe për mjetet e nevojshme të punës (cilat mjete janë të nevojshme dhe pse).
Përpunimi i masave të sigurisë	Së bashku me nxënësin të lexohen rregullat e sigurisë mbi enën e ngjyrës (Dhënie të impulseve: Ai duhet të sqarojë, çka i bie ndërmend). Të pyetet për kuptimin. Të veçohen masat më të rëndësishme të sigurisë: <ul style="list-style-type: none"> - Hapja e dritareve - Të mos pihet duhan - Përdorimi i dorëzave

2. Faza e përpunimit
<p>Gjatë fazës së përpunimit nxënësi udhëhiqet me anë të impulseve dhe pyetjeve. Së pari pyetet se si do ta kryente ai këtë punë. Para së të fillojë zbatimin, nxënësi duhet të provojë hapat e punës pa ngjyrë. Me këtë rast duhet të veçohet përpunimi i këtyre pikave:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbajtja e furçës: Nxënësi duhet të mbajë furçën njëherë si një reketë (tenisi) dhe një herë si laps, në mënyrë që të mund ta ndjejë dallimin. Së fundi me rëndësi është që furça të mbahet sikurse lapsi në dorë, në mënyrë që gjatë ngjyrosjes të përdorë ndieshmërinë e hollësishme të mollëzave të gishtërinjëve. - Pasja parasysh e dejetimeve të drurit: Gjatë bartjes së ngjyrosjes me anë të furçës të ecet pas në drejtim të dejetimit, gjatë shpërndarjes së ngjyrës në drejtim të kundërt me dejetime. Me këtë rast nxënësi duhet paraprakisht të përcaktojë drejtimin e dejetimeve respektivisht atë të drurit, në mënyrë që të vlerësojmë se a i ka kuptuar ai këto terme. Përveç kësaj nxënësi duhet të kuptojë se si e ka bërë bartjen e furçës mbi sipërfaqe. <p>Përpunimi i veprimt bëhet në bazë të parimit të ndarjes kohore të punës. Të gjithë hapat e punës do të zbatohen nga vetë nxënësi. Me këtë rast ai duhet vetë të përshkruajë se si po vepron dhe të arsyetojë veprimin e tillë. Nëse nxënësi ka vështirësi në ndonjërin hap të punës, ai do të përkrahet me anë të dhënies së impulseve të përshtatshme. Vetëm nëse nuk ka mundësi tjetër, bëhet demonstrimi i një pjese.</p> <p>Me rëndësi është edhe këshilla, se gjatë përpunimit, rol më të rëndësishëm ka një zbatim i kujdesshëm i punës se sa një punë e kryer shpejt. Natyrisht se me këtë rast duhet respektuar kohën e dhënë për ngjyrë.</p> <p>Për fillimin e punës aplikohen masat e lartpërmendura të sigurisë.</p>



Ecuria e punës

Ngjarja e pjeshme (Çka ndodhë?)	Këshillat zbatuese (Si ndodhë kjo?)	Arsyetimi (Përse ndodhë kështu?)	Këshillat metodike
------------------------------------	--	-------------------------------------	--------------------

Faza e kontrollimit

Përmbajtja mësimore	Këshillat metodike
Kontrollimi i të pamurit, përshtypja optike e sipërfaqes së ngjyrosur.	Nxënësi duhet të shënojë se si e vlerëson ai vetë punën e tij. Ai duhet të sqarojë se çka ka bërë mirë e çka jo, respektivisht çka do të kishte mundur të përmirësonte.
Kontrollimi i nuancës së ngjyrës bazuar në provën e ngjyrës	Nxënësi udhëzohet që sipërfaqën e ngjyrosur ta krahasojë me provën e ngjyrës dhe të vlerësoj se a është në rregull nuanca e ngjyrës.
Kontrollimi i të mësuarës	Nxënësi duhet edhe njëherë shkurtimisht të përmbledhë hapat kryesor të punës, në rast nevojë të pyetet se cilat masa të sigurisë duhet pasur kujdes, se çfarë enësh nuk guxojnë të përdoren dhe se çfarë duhet pasur kujdes gjatë krahasimit me provën e ngjyrës.
Reagimet nga ana e mësimitdhënësit	Të jipen këshilla, çka është pozitive e çka negative në punim; motivimi i nxënësit për ushtrime të mëtejme.

Faza e ushtrimit

Nxënësit i ndahen detyra njëra pas tjetrës, në mënyrë që të thelloj teknikën e ngjyrosjes, p.sh. ngjyrosja e një sipërfaqe të drejtë. Të veçantat e detyrave të ushtrimit duhet përpunuar së bashku, para fillimit të fazave kalimtare.

Evitoni këto gabime, që mund t'u ndodhin mësimitdhënësve gjatë mësimit praktik:

- Tema e mësimit praktik është shumë e gjerë
- Në fillim nuk emërtohet qëllimi i mësimit
- Mosvënia në kontakt me nxënësit
- Mësimitdhënësi e „bombardon“ nxënësin me fakte / informata - Mbingarkesë!
- Mosvënia e kontaktit përmes syve
- Mosaktivizimi i nxënësit (fare apo pak pyetje)
- Mësimitdhënësi parashtron pyetje por vetëpërgjigjet në monologje të gjata
- Mosreagimi adekuat i mësimitdhënësit ndaj përgjigjeve të gabuara apo jo të plota demotivim
- Mezi i kuptueshëm
- Mosvërtetimi i suksesit